



Në bazë të nenit 53 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 47 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt. 31.01.2018, bjen këtë :

## V E N D I M

### MBI FORMIMIN E KOMITETIT TË KOMUNITETEVE

#### I.

Formohet Komiteti i Komuniteteve pranë Kuvendit të Komunës së Deçanit në këtë përbërje:

1. Hurka Halilaj, përfaqësuese e Komunitetit Boshnjak,
2. Elmir Nezaj, përfaqësues i Komunitetit Egjiptian
3. Jetmir Belaj, përfaqësues i Komunitetit Rom,
4. Boshko Çiriç, përfaqësues i Komunitetit Serb,
5. Millanka Popoviq, përfaqësuese e Komunitetit Malazez,
6. Fekri Qufaj (AAK), nga Asambleja,
7. Opozita nga Asambleja në këtë Komitet do të përfaqësohen me rrotacion: Besnik Hulaj (LDK) në vitin 2018 dhe 2019, Kestrim Avdimetaj (PDK) në vitin 2020 dhe Natyra Kuçi (VV) në vitin 2021.

Komiteti do ta zgjedhë Kryesuesin e vet në mbledhjen e parë që do ta mbajnë, e cila mbledhje do të ftohet nga Kryesuesi i Kuvendit.

#### II.

Komiteti i Komuniteteve është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për tu siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Komiteti gjithashtu i rekomandon kuvendit të komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për tu avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

#### III.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Me Vendim njoftohen:

- Të emruarit në pikën I. Të Vendimit dhe
- Arhivi.

01.Nr.I-8

Deçan, dt. 31.01.2018

|                                                             |            |                      |          |
|-------------------------------------------------------------|------------|----------------------|----------|
|                                                             |            | HYRESE/LAZMA-INGOING |          |
| REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA |            |                      |          |
| KOMUNA E DEÇANIT • OPSTINA DEÇANE • DECANI MUNICIPALITY     |            |                      |          |
| Nga:                                                        |            | Nr. Prot:            |          |
| Që:                                                         |            | Bz. Prot:            | 3518     |
| From:                                                       | K.K. Deçan | Prot. No:            |          |
| Nr. ftoqes:                                                 |            | Data:                |          |
| Dr. Shprehur:                                               | 01         | Datum:               | 05.02.18 |
| No. Ftoqes:                                                 |            | Date:                |          |
| DECANI DEÇANE                                               |            |                      |          |



Kryesuesi:  
Haki Shehaj